




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**



Datë: 20.02.2024  
Ref. KM -78/24

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), neni 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18.11.2022), bazuar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën I pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**V E N D I M**

**Për dhënien në shfrytëzim të Kullës së Ministerit**

1. Me qëllim të zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 05.02.2024, Ministria përgjegjëse për bujqësi ofron në shfrytëzim objektin e Kullës së Ministerit për periudhën kohore dhjetë (10) vjeçare 2024-2033 Ministrisë përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport.
2. Kulla e Ministerit e dhënë në shfrytëzim nga pika e 1 e këtij vendimi është pronë Shoqërore (PSH) Organit Drejtues Enti për Pemëtari dhe Perimtari në kuadër të Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë i cili është nën menaxhimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me sipërfaqe të përgjithshme prej 5795m<sup>2</sup> në Parcelën Kadastrale P-71611071-04541-1 Zona Kadastrale Pejë, Komuna e Pejës.
3. Kulla e Ministerit nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi mund të shfrytëzohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Mjetet financiare për funksionalizimin e Kullës bëhen dhe mbulohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të monumentit.

5. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Faton PEÇI**

**Ministër**

*Vendimi t'i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit të MBPZHR;*
- *Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë, dhe*
- *Arkivit.*